

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

AMOR - ADORION *shpk*

Në Tiranë, sot më datë 09.05.2022, ne të poshtë shënuarit:

1.Luan LAZAJ i datëlindjes 01.05.1963,lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: G33501007W, dhe

2.Urani LAZAJ BREGASI i datëlindjes 16.03.1963,lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID , me numër personal: G38316003A,

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit “, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e emertuar “**AMOR - ADORION**” *shpk*

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin : “**AMOR - ADORION**” *shpk* dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria “ “**AMOR - ADORION**” *shpk*).

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Selia e Shoqërisë “**AMOR - ADORION**” *shpk* do te jete: Zona kadastrale 3796, numer pasurie 335/198, volum 6/91, Vlashaj, Maminas, Durres.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Import-Eksport, ndertime civile, punime hidraulike dhe elektrike, organizime evente te bareve dhe restoranteve.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pacaktuar dhe mund të shpërbehet me vendim të ortakeve të saj në çdo kohë.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

1. Luan Lazaj zotëron 50 % kuota me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë

2. Urani Bregasi Lazaj, zotëron 50% kuota me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;



- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

1. **Luan LAZAJ** i datëlindjes 01.05.1963 banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: G33501007W emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.
2. **Urani BREGASI LAZAJ** i datëlindjes 16.03.1963 banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: G38316003A, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "AMOR - ADORION" shpk nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

Autorizohet Klodiana Mengri me ID: H15625091C, te Aplikoj per regjistrim e Shoqerise ne E-Albania.

Ortakët: **Luan LAZAJ**

Ortakët: **Urani BREGASI LAZAJ**

ORTAKËT THEMELUES

Luan Lazaj
Urani Bregasi Lazaj